Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| Data 23.08.23 | Vendi KAÇANIK | |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 370/01 - 21457 | -/- |

# KONTRATË PËR PUNË

**KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), **të cilën e përfaqëson Shefket Koxha Menagjer i ZP**në njëren anë; dhe

**"HIDRO ING" SHPK** të cilën e përfaqëson **Hakif Binaku pronar** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

**RREGULLIMI DHE MONTIMI I RRJETATVE, KABINAT DHE RRETHOJA TE STADIUMI I QYTETIT"-Ritender** me numër Identifikues **652-23-7657-5-3-6**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë *Rregullimi dhe montmi i rrjetave , kabinat dhe rrethojave te stadiumi i qytetit.*

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 24.*08.2023* dhe përfundon pas 20 ditë kalendarik.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *2* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i *ekzekutimit të punëve* do të jetë *Stadiumi i qytetit.*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[1] (Detyra e Dërguar e Paguar).

[1] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: 8,392.90€; tetëmijëetreqindenantdhjetedyEuro dhe 90 cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *punëve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e

Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *punëve.*

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] [ *të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet*] [*te kryej ndonjë ose te gjitha punët*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* *[punëve]* *[shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqip*[2] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik** **Për Autoritetin Kontraktues**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | Hakif Binaku | **Emri:** | Shefket Koxha |
| Pozita: | Pronar | Pozita: | Menaxher i ZP |
| Nënshkrimi: | [signature] | Nënshkrimi: | [signature] |
| Data: | 22.08.2023 | Data: | 23.08.2023 |
| **Vula:** | [stamp: SH.P.K. HIDRO-ING Mazgit OBILIQ] | **Vula:** | [stamp: REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA] |

2 Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

## RRJETAT, KABINAT DHE RRETHOJA TE STADIUMI I QYTETIT

| 1 | RRJETAT DHE KABINAT | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Lloji i punëve | Njesia | Sasia | Çmimi | Totali |
| 1.1 | Sigurimi transporti dhe montimi i rrjetes per porta . Verejtje: Materiali dhe dimensionet e rrjetes duhet te jene sipas standarteve te FIFA-së | copë | 2 | 230.00 | 460.00 € |
| 1.2 | Sigurimi transporti dhe montimi i mbuleses per kabinat e rezervist (kabina e parapare per 16 persona), nga materiali i plexiglass ose i ngjashem. Ne llogari hyn te gjitha pozicionet e nevojshme per funksionalizimin e pozicionit. Mbulesa duhet te montohet ne konsturksionin ekzistues. | copë | 2 | 220.00 | 440.00 € |
| 1.3 | Sigurimi transporti dhe montimi i mbuleses per kabinat e delegatëve(kabina e parapare per 3 persona), nga materiali i plexiglass ose i ngjashem. Ne llogari hyn te gjitha pozicionet e nevojshme per funksionalizimin e pozicionit. Mbulesa duhet te montohet ne konsturksionin ekzistues. | copë | 1 | 100.00 | 100.00 € |
| | Totali 1: | | | | 1,000.00 € |

| 2 | RRETHOJA | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Lloji i punëve | Njesia | Sasia | Çmimi | Totali |
| 2.1 | Gërmimi i dheut të kat së III dhe IV për hapjen e gropës së themelit me makineri dhe me dorë.Dimensionet e gropës së themelit janë: gropa me dimensione 50*50*50cm. Këtu nënkuptohet planifikimi i fundit të gropës së themelit dhe largimi i dheut të tepërt pas betonimit të themelit deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës. Llogaria bëhet për $m^3$ të dheut të gërmuar. | $m^3$ | 9.72 | 25.00 | 243.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.2 | Sigurimi dhe shtrimi i materialit të zhavorit të seperuar me fraksion 0-31.5 mm në bazën e gropës së themelit me trashësi mesatare d=10cm në gjendje të ngjeshur.<br>Llogaria bëhet për m³ të zhavorit. | m³ | 1.62 | 25.00 | 40.50 € |
| 2.3 | Sigurimi dhe montimi i shtyllave metalike nga materiali i qelikut të petëzuar me dimensione:10cm*10cm*3mm. Lartësia e shtyllave të jetë 2.0m. Në llogari hynë: Punimi i pllakes ankeruse (me dimensione 25cm*25cm me trashesi 5mm)e cila saldohet ne shtyllë si dhe ankerimi i saj ne bazen e betonit me Ankerbulona M12,lyerja me ngjyrë bazë (dy herë) për metale, lyerja me bojë- ngjyrë sipas preferencës së investitorit (në dy shtresa) me ngjyrë sipas kërkesës së investitorit dhe punimi i kapsëve ku do të montohet rrjeta.<br>Pozicioni te realizohet sipas detalit te bashkangjitur. | copë | 45 | 28.00 | 1,260.00 € |
| 2.4 | Sigurimi, transporti dhe montimi i rrjetave metalike nga materiali i qelikut të zinktuar me dimensione të hapjeve 50*50 me t=3.1mm të mbështjelluar me materiali plastik të gjelbër. Lartësia e rrjetes te jete 2 m. Në llogari hyn edhe montimi i telit te qelikut ne menyre horizontale pergjate tere gjatesise se rrethojes ne pjesen e siperme ne mes dhe ne fund te rrethojes. | m² | 327.6 | 14.00 | 4,586.40 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.5 | Sigurimi, transporti dhe punimi i themeleve te betonit te klasit C25/30 ne llogari hyn edhe punimi i pahive. | $m^3$ | 5.63 | 100.00 | 563.00 € |
| 2.6 | Sigurimi, transporti dhe punimi i portes hyrese nga konstruksioni metalik me dimensione 200cm*200cm. Ne llogari hyn punimi i shtyllave mbajtese me dimensione 10cm*10cm me trashesi te murit 3mm si dhe lartesi 2m, punimi I deres me profile 6cm*3cm me trashesi te murit 3mm dhe lartesi 200 cm ne te cilat montohet rrjeta metalike nga materiali i qelikut të zinktuar me dimensione të hapjeve 50*50 me t=3.1mm të mbështjelluar me materiali plastik të gjelbër, punimi i mekanizmave për hapjen dhe mbylljen e dyerve si dhe bagllamave per montimin ne shtyllat kryesore. Pozicioni realizohet sipas detalit te bashkangjitur. | copë | 1 | 700.00 | 700.00 € |
| | Totali 2: | | | | 7,392.90 € |

**Vërejte!**

*Të gjitha çmimet e pozicioneve janë të llogaritura me TVSH.*

*Në të gjitha pozicionet nënkuptohet furnizimi dhe transporti i të gjitha materialeve duke e llogaritur edhe punën për realizimin e pozicionit, më të gjitha elementet përcjellëse.*

*Të gjitha materialet para përdorimit duhet të prezentohen për miratim nga organi mbikqyrës.*

*Punëkryesi duhet që me kujdes të realizoj punën, pasi për çdo dëmtim të instalimeve(ujësjellësit, kanalizimit, rrymës, etj.), i bartë shpenzimet per rregullimin e defekteve eventuale.*

*Punëkryesi I bartë shpenzimet për të gjitha atestet e materialeve dhe ekzaminimeve të cilat nevoiten në këtë rast dhe atestet dhe ekzaminimet shtesë të cilat kërkohen nga organi mbikqyrës.*

*Gjatë punimeve punëkryesi është I obliguar të vendos shenjat për punime në rrugë dhe organizimin e trafikut.*

| | REKAPITULIM | |
|---|---|---|
| 1 | RRJETAT DHE KABINAT | 1,000.00 € |
| 2 | RRETHOJA | 7,392.90 € |
| | TOTALI: | 8,392.90 € |

Punoi:
DKRS